



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.63 dt.24.04.1998

“PER SHITJE TROJESH SHTETERORE TE ZENA”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e dt.24.04.1998, në bazë të relacionit paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës “Për shitje trojesh shtetërore të zëna”, mbështetur në ligjin Nr.7980, “Për shitblerjen e trojeve”, dt.27.07.1995, ligjit Nr.7572 dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal”, ligjit Nr.7693 dt.06.04.1993 “Për urbanistikën”, V.K.M. Nr.312 dt.30.06.1994 “Për çmimin e shitjes së trojeve”, Shkresës së K.M. Nr.4079, prot.dt.24.12.1997 që le në fuqi V.K.M. Nr.312, V.K.B. Nr.165, dt.29.09.1997 “Për miratimin e rregullores për shitjen e trojeve personave fizikë e juridikë vendas apo të huaj për rastet kur është ndërtuar mbi to”,

VENDOSI

- 1.Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “Albafredi” për blerjen e truallit 3.000m² në Rrugën e “Durrësit” ku është ndërtuar pikë karburanti e servis.
- 2.Të miratojë kërkesën e Z.Halim Kosova për blerjen e një trualli 69m² ku është ndërtuar “Klinikë Gjinekologjike” në Rrugën “Muhamet Gjollesha”
- 3.Të miratojë kërkesën e Z.Shkëlqim Bumci për blerjen e një trualli 60m² në Rrugën “Gjik Kuqali” për të plotësuar sipërfaqen e kompesuar të pronës së tij.
- 4.Të miratojë kërkesën e Z.Petraç Karapanxha për blerjen e truallit prej 100m² në Rrugën “Ndre Mjeda” për ndërtimin e një banese si i pastrehë.
- 5.Të miratojë kërkesën e Z.Shëndet Duro, për blerjen e truallit në të cilën ka investuar sipas lejes së K.RR.T.së prej 188m² në Rrugën “Konferenca e Pezës”.

6. Të miratojë kërkesën e kompanisë “Y.Y.Internacional” për blerjen e truallit të zënë nga investimet prej 3.500m² në zonën e ish Aeroporti i Vjetër për ndërtimin e “Kompleks banesash”.
7. Të mos miratojë kërkesën e Kompanisë “Gulf Mery Project Hospital” për blerjen e truallit ndërtim spitali bamirës në Sauk.
8. Nga kërkesa e Kompanisë “Mak – Albania” për blerjen e truallit prej 30.000m², të miratohet 23.000m² përbri sheshit Italia. Me ndërtimin e hotelit të zëvendësohet gjelbërimi i dëmtuar dhe të plotësohet gjithë mjedisi. Pjesa tjetër për rreth 7.000m² është pronësi private.
9. Të miratojë kërkesën e Kompanisë “Gintash Alb – Konstruktion” për blerjen e sip.së truallit mbi të cilin është investuar prej 7.327m² në Laprakë për ndërtimin kompleks banimi.
10. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “Abu – Dhabi” për blerjen e truallit 450m² i zënë me investim në Rrugën “Sulejman Delvina”.
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike
12. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

